



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-05  
**Prokurori k. Salih Mustafës**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatësi Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 3 dhjetor 2020

**Gjuha:** Anglisht

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër për caktimin e datës së konferencës së tretë mbi ecurinë e çështjes**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të të akuzuarit**  
Julius von Bóné

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave së Specializuar të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 28 shtator 2020, i akuzuari Salih Mustafa ("z. Mustafa") mori pjesë në paraqitjen e tij të parë dhe refuzoi të deklarohej lidhur me fajësinë ose pafajësinë e tij<sup>2</sup>.

2. Më 5 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore dhe çështjet e lidhura me të<sup>3</sup>. Të dyja palët depozituan para seancës parashtrimet me shkrim mbi listën e pikave që do të diskutoheshin<sup>4</sup>.

3. Më 9 tetor 2020, pas parashtrimeve nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake<sup>5</sup>, lëshoi një vendim kornizë për nxjerrjen e provave dhe çështjeve të lidhura me to, duke përcaktuar procesin e nxjerrjes që vazhdon në janar të vitit 2021<sup>6</sup>.

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, Transkript, 28 shtator 2020, publik, f. 11, rreshtat 24-25.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes*, 30 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, publike; KSC-BC-2020-05, Transkriptim, datë 5 tetor 2020, f. 19-46, publike. (titujt duhen cituar nga tabela që ka krijuar Ante e cila përditësohet vazhdimisht)

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, F00029, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes për konferencën mbi ecurinë e çështjes që do të mbahet më 5 tetor 2020*, publike; KSC-BC-2020-05, F00030, Prokurori i Specializuar, *Version i redaktuar publik i parashtrimeve të Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes*, 5 tetor 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F00024, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime lidhur me sistemin e redaktimit*, 1 tetor 2020, publike; F00029, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes për konferencën mbi ecurinë e çështjes që do të mbahet më 5 tetor 2020*, 5 tetor 2020, publike; F00030, Prokurori i Specializuar, *Versioni i redaktuar publik i parashtrimeve të Prokurorit për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes*, 5 tetor 2020, publik; KSC-BC-2020-05, Transkript, 5 tetor 2020, f. 19-46, publik.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë për nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse*, 9 tetor 2020, publik.

4. Më 20 tetor 2020, pas një kërkesë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS")<sup>7</sup>, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e parë për masat mbrojtëse<sup>8</sup>.
5. Më 28 tetor 2020, Z. Mustafa u vetëdeklarua i pafajshëm<sup>9</sup>. Në të njëjtën seancë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e dytë për ecurinë e çështjes gjyqësore dhe çështjet e lidhura me të<sup>10</sup>.
6. Më 5 nëntor 2020, pas një propozimi të përbashkët nga ZPS-ja dhe Mbrojtja<sup>11</sup>, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim për miratimin e një tablele kategorizimi për nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 109 (c)<sup>12</sup>.
7. Më 24 nëntor 2020, në bazë të një kërkesë të dytë nga ZPS-ja<sup>13</sup>, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e dytë për masat mbrojtëse<sup>14</sup>.
8. Më 1 dhjetor 2020, ZPS-ja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se e kishte njoftuar Mbrojtjen për materialet dhe provat sipas rregullës 102(3) të Rregullores<sup>15</sup>.

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-05, F00035, Prokurori i Specializuar, *Version konfidencial i redaktuar i kërkesës për masa mbrojtëse*, 12 tetor 2020, konfidencial.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-05, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version konfidencial i redaktuar i vendimit të parë në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për masa mbrojtëse*, 20 tetor 2020, konfidencial.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-05, Transkript, 28 tetor 2020, publik, f. 60, rreshtat 2-17.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-05, F00039, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së seancës për vetëdeklarim në lidhje me fajësinë ose pafajësinë dhe të konferencës së dytë për ecurinë e çështjes*, 19 tetor 2020, publike; KSC-BC-2020-05, Transkript, 28 tetor 2020, publike.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-05, F00045, Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja për z. Mustafa, *Parashtrim i përbashkët i tabelës së kategorizimit sipas rregullës 109(c)*, 4 nëntor 2020, publik.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-05, F00046, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për rishikim ose leje për apelim*, 5 nëntor 2020, publik.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-05, F00047, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version konfidencial i redaktuar i kërkesës së dytë për masa mbrojtëse*, 11 nëntor 2020, konfidencial.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-05, F00053, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version konfidencial i redaktuar i vendimit të dytë në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për masa mbrojtëse*, 24 nëntor 2020, konfidencial.

<sup>15</sup> KSC-BC-2020-05, F00057, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorit të Specializuar për nxjerrje të materialeve në pajtim me rregullën 102(3)*, 1 dhjetor 2020, publik.

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Në pajtim me rregullën 96 (1) të Rregullores, pas konferencës së parë për ecurinë e çështjes gjyqësore, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferenca pasuese mbi ecurinë e çështjes gjyqësore, siç konsiderohet e nevojshme, në mënyrë që: (i) të organizojë shkëmbime midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, në mënyrë që të sigurojë përgatitje të shpejtë për gjykim; (ii) të ndërmarrë hapa për të siguruar realizimin e të gjitha përgatitjeve të nevojshme nga palët në kohën e duhur dhe në mënyrë të zellshme; dhe (iii) të analizojë ecurinë e çështjes dhe t'u lejojë palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, mundësinë për të ngritur probleme në lidhje me çështjen gjyqësore.

10. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, të gjitha provat materiale dhe relevante ose faktet në posedim të ZPS-së, të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, do t'i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, objekt vetëm ndaj kufizimeve të cilat janë rreptësisht të domosdoshme dhe kur zbatohet ndonjë mbrojtje e nevojshme balancuese. Në pajtim me rregullën 102 (3) të Rregullores, ZPS-ja do t'i japë njoftim të hollësishëm Mbrojtjes mbi çdo material dhe provë në posedim të saj.

11. Në pajtim me rregullën 95 (2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, përcakton një kalendar dhe planin e punës për çdo detyrim të palëve gjatë procedurës paraprake; cakton afatet kohore për nxjerrjen e materialeve; ndërmerr hapa për të identifikuar dhe shkurtuar listën e pikave që janë objekt mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve dhe të atyre që nuk janë objekt mosmarrëveshjeje; vendos për mocionet për masa mbrojtëse; dhe cakton një datë të synuar për kohën kur çështja është gati për gjykim.

12. Në pajtim me rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të paraqesë, brenda një afati të caktuar kohe: (i) dosjen e procedurës paraprake, përfshirë çdo pranim nga Mbrojtja dhe një deklaratë të çështjeve që nuk janë në diskutim; (ii) një listë të dëshmitarëve që synon të thërrasë; dhe (iii) një listë të

provave materiale që ajo synon të paraqesë, duke përfshirë, kur është e mundur, çdo kundërshtim të Mbrojtjes për vërtetësinë.

13. Në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve sipas rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e fton Mbrojtjen të paraqesë dosjen e procedurës paraprake brenda një afati të caktuar. Për më tepër, brenda një afati kohor të caktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja e njofton ZPS-në për qëllimin e saj për të ofruar mbrojtje për alibi ose ndonjë arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, duke përfshirë aftësinë mendore të kufizuar, ose mungesën e aftësisë mendore, intoksikimin, domosdoshmërinë, dhe gabime faktike ose ligjore.

14. Në pajtim me rregullën 96 (2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit pas marrjes së këshillave nga mbrojtësi, mund të zhvillohet një konferencë për ecurinë e çështjes gjyqësore: (i) në praninë e të akuzuarit, me mbrojtësin që merr pjesë përmes videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit, me të akuzuarin që merr pjesë përmes videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me mbrojtësin të pranishëm ose që merr pjesë përmes videokonferencës.

### III. DISKUTIM

15. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores dhe për të siguruar përgatitje të shpejtë për gjykim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën e tretë për ecurinë e çështjes të hënën, datë 14 dhjetor 2020, në orën 15:00.

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë nga palët të bëjnë përditësimet e tyre, nëse kanë, në lidhje me pikat e mbetura ende pezull nga konferencat e mëparshme për ecurinë e çështjes. Konkretisht dhe përveç kësaj, Gjykatësi i procedurës paraprake do të kërkojë përditësime për pikat vijuese sipas rendit të paraqitur më poshtë:

(1) Nxjerrja e materialeve

- a. Në kuadrin e hapave të përfunduar për nxjerrjen e provave nga ZPS-ja, nëse palët po përballen ose parashikojnë të përballen me ndonjë vështirësi sa i takon pjesës së mbetur të procesit të nxjerrjes;
- b. Nëse ZPS-ja ka ende prova shfajësuese nën ruajtje, kontroll, ose për të cilat është aktualisht në dijeni, të cilat duhet t'i zbulohen Mbrojtjes, në përputhje me rregullën 103 të Rregullores;

(2) Hetimet

- c. Nëse kanë përfunduar hapat hetimore të papërfunduara të ZPS-së, ose nëse mund të jepet një vlerësim për datën e përfundimit të tyre;
- d. Nëse vlerësimi i mëparshëm paraprak i ZPS-së për dorëzimin, nga fundi i shkurtit të vitit 2021<sup>16</sup>, të dosjes së procedurës paraprake dhe materialeve të tjera të lidhura me të, të përmendura në rregullën 95(4)(a) - (c) të Rregullores është ende i vlefshëm në dritën e pjesës së mbetur të nxjerrjes së materialeve dhe të çdo kërkesë pasuese të Mbrojtjes, si dhe hetimeve në vazhdim;
- e. Bazuar në vlerësimin e ZPS-së mbi pikën e mësipërme dhe pjesën e mbetur të procesit të nxjerrjes së materialeve (planifikuar të vazhdojë në fund të janarit 2021), nëse Mbrojtja është në gjendje të ofrojë përditësime mbi statusin e hetimeve të saj dhe për afërsisht sa kohë do t'i duhet të përfundojë veprimtari të tilla hetimore;
- f. Bazuar në vlerësimin e Mbrojtjes lidhur me pikën e mësipërme, nëse, që nga konferenca e dytë për ecurinë e çështjes<sup>17</sup>, ajo ka bërë ndonjë përparim në lidhje me:
  - (i) synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale në pajtim me

---

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-05, Transkript, 28 tetor 2020, publik, f. 81, rreshtat 6-13.

<sup>17</sup> KSC-BC-2020-05, Transkript, 28 tetor 2020, publik, f. 83, rreshtat 2-22.

rregullën 95(5) të Rregullores, dhe çdo nxjerrje të lidhur të dokumenteve, në përputhje me rregullën 104(1) dhe (2) të Rregullores; dhe

- (ii) synimin për të bërë kërkesa lidhur me mundësi hetimore unike, në përputhje me rregullën 99(1) të Rregullores;

(3) Pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen

- g. Nëse palët kanë hyrë në diskutime në lidhje me mundësinë për të paraqitur pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen, në pajtim me rregullat 95 (3) dhe 156 të Rregullores;
- h. Kur presin palët të jenë në gjendje të identifikojnë një listë pikash për të cilat nuk pajtohen dhe një listë pikash për të cilat pajtohen.

(4) Hapat e tjerë proceduralë

- i. Nëse Mbrojtja parashikon të dorëzojë dosjen paraprake dhe materiale të tjera të parashikuara në rregullën 95(5) të Rregullores dhe, nëse po, kur pret të jetë në gjendje të dorëzojë dosjen paraprake;
- j. Kur mendojnë palët të jenë gati për gjykimin.

17. Në fund, palëve do t'u kërkohet të bëjnë të ditura pikëpamjet e tyre në lidhje me datën e konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes, nëse gjykohet e nevojshme.

18. Palët janë të ftuara të paraqesin parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, deri të enjten, datë 10 dhjetor 2020 për ndonjë nga temat e mësipërme, duke përfshirë temat e diskutuara në konferencat e mëparshme për ecurinë e çështjes gjyqësore, ose ndonjë temë tjetër lidhur me të, e cila nuk trajtohet në këtë urdhër.

## IV. VENDIM

19. Për arsyet e mësipërme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake,:

- a. **VENDOS** të mbledhë konferencën për ecurinë e çështjes gjyqësore në prani të ZPS-së dhe Mbrojtjes të **hënën, datë 14 dhjetor 2020, në orën 15:00**; dhe
- b. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen të dorëzojnë parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, deri të **enjten, datë 10 dhjetor 2020**, siç përcaktohet në paragrafin **Error! Reference source not found..**

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatësi Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E enjte, 3 dhjetor 2020  
Në Hagë, Holandë.